



REPUBLIKA E KOSOVËS – PRESIDENTI
REPUBLIC OF KOSOVO – THE PRESIDENT
REPUBLIKA KOSOVO – PRESEDNIK

DEKRET PËR RATIFIKIM TË MARRËVESHJES
NDËRKOMBËTARE

Duke u bazuar në nenin 18, paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në nenin 10 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 04/L – 052, për Marrëveshjet Ndërkombëtare si dhe në nenin 4, paragrafi 3 të Ligjit Nr. 03/L – 044, për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik:

D e k r e t o j

Ratifikimin e Marrëveshjes për Transportin Ndërkombëtar Rrugor të Udhëtareve dhe të Mallrave, në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Sllovenisë, e nënshkruar në Lubjanë, më 26 qershor 2013 dhe të pranuar në Zyrën e Presidentit të Republikës së Kosovës me datë 19 gusht 2015.

Marrëveshja e ratifikuar i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për njoftim, në përputhje me nenin 18, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Marrëveshja e ratifikuar hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare.

Nr. i Dekretit: DMN – 018 – 2015.

Prishtinë, më 24 gusht 2015.



Atifete Jahjaga

Presidente e Republikës së Kosovës

MARRËVESHJE

NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SLLOVENISË MBI TRANSPORTIN NDËRKOMBËTAR RRUGOR TË UDHËTARËVE DHE TË MALLRAVE

Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Qeveria e Republikës së Sllovenisë, më tej në tekst, Palët Kontraktuese,

Të gatshëm për të zhvilluar marrëdhëniet tregtare dhe ekonomike ndërmjet dy vendeve;

Të vendosur për të promovuar bashkëpunimin në transportin ndërkombëtar brenda kornizës së tregut ekonomik;

Të brengosur për mbrojtjen e mjedisit dhe njerëzve, konsumin racional të energjisë, sigurinë në rrugë dhe përmirësimin e kushteve të punës për vozitësit;

Duke synuar zhvillimin e intermodalitetit të transportit;

Duke njohur interesin e përbashkët dhe përparësitë e një marrëveshjeje mbi transportin ndërkombëtar rrugor,

Pajtohen si në vijim:

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Fushëveprimi

1. Kjo Marrëveshje rregullon transportin ndërkombëtar rrugor të udhëtarëve dhe mallrave, të kryera nga operatorët e transportit të themeluar në territorin e Palës Kontraktuese, me anë të automjeteve të regjistruara në atë territor, me pikat e nisjes në territorin e njërës Palë Kontraktuese dhe me destinacion në tjetrën Palë Kontraktuese ose transit përmes territorit të njërës nga Palët Kontraktuese.

2. Kjo marrëveshje nuk prek të drejtat dhe detyrimet që dalin nga ndonjë zotim tjetër ndërkombëtar i të dy Palëve Kontraktuese, e as nuk ndikon në rregulloret e Bashkimit Evropian dhe marrëveshjet ndërkombëtare ndërmjet Bashkimit Evropian dhe shteteve jo-anëtare.

Neni 2

Përkufizimet

Në këtë Marrëveshje, disa nga termet në vijim kanë këtë kuptim:

1. “Operatori i transportit” nënkupton çdo person fizik ose ligjor i autorizuar për kryerjen e transportit ndërkombëtar rrugor të udhëtarëve dhe mallrave në përputhje me rregulloren e Palës Kontraktuese në të cilin territor është themeluar.
2. “Automjeti” nënkupton automjetin motorik apo një kombinim të automjeteve të regjistruara në territorin e njëres nga Palët Kontraktuese dhe në bazë të konstruktimit të tij dhe pajisjeve e dedikuar për transportin ndërkombëtar të udhëtarëve dhe mallrave, në dispozicion të operatorit të transportit duke qenë në pronësi të tij ose përmes një kontrate qiramarrjeje dhe qiradhënieje.
3. “Autobusi” nënkupton automjetin e regjistruar në territorin e njëres nga Palët Kontraktuese që në bazë të konstruktimit dhe pajisjeve është i përshtatshëm dhe i dedikuar për transportin e udhëtarëve dhe të cilët kanë, përveç ulëses së vozitësit, më shumë se tetë ulëse.
4. “Transporti” nënkupton operimet e automjeteve të ngarkuara ose të pangarkuara, duke përfshirë edhe transportin e automjeteve, për një pjesë të udhëtimit, me tren ose anije.
5. “Kabotazhi (lundrim bregdetar)” nënkupton transportin e udhëtarëve apo mallrave në mes disa pikave brenda territorit të njëres Palë Kontraktuese, të kryer nga një operator i transportit i Palës tjetër Kontraktuese.
6. “Transporti i kombinuar” nënkupton transportin e mallrave me anën e të cilit kamioni, rimorkio, gjysmë-rimorkio, kontejneri, me apo pa traktor, shfrytëzojnë rrugën për fazën fillestare apo të fundit të udhëtimit, e cila është sa më e shkurtë që të jetë e mundur, dhe shfrytëzojnë hekurudhën, kanalën e lundrimit apo detin për shumicën e udhëtimit.
7. “Territori i Palës Kontraktuese” nënkupton territorin e Republikës së Kosovës dhe territorin e Republikës së Sllovenisë.
8. “Vendi i Themelimit” nënkupton territorin e Palës Kontraktuese brenda të cilit është themeluar operatori i transportit dhe në të cilin është regjistruar automjeti.

9. “Vendi Pritës” nënkupton territorin e Palës Kontraktuese në të cilin operon operatori i transportit pa pasur të regjistruar automjetin atje dhe pa pasur të themeluar operatorin e transportit atje.
10. “Shërbimi i rregullt i udhëtarëve” nënkupton shërbimin i cili bart udhëtarët në një linjë të specifikuar, sipas orarit dhe listës së çmimit paraprakisht të vendosur dhe të publikuar. Shërbimi i rregullt i udhëtarëve u dedikohet të gjithëve sipas kushteve të njëjta, duke marrë udhëtarët dhe duke i zbritur ata në vendndalimet e paracaktuara.
11. “Linja vajtje-ardhje” nënkupton shërbimin me anën e të cilës, me anë të udhëtimeve të përsëritura vajtje-ardhje, grupet paraprakisht të organizuara të udhëtarëve barten nga një vend i vetëm i nisjes në një destinacion të vetëm. Vendi i nisjes dhe vendi i destinacionit nënkuptojnë vendin ku fillon udhëtimi dhe vendin ku përfundon udhëtimi, së bashku me, në secilin rast, lokalitetin më të afërt me radius prej 50 km. Secili grup përbëhet prej udhëtarëve të cilët udhëtojnë së bashku dhe kthehen në vendin e nisjes me udhëtimin e mëvonshëm. Shërbimi i linjës vajtje-ardhje nuk ndikohet nga fakti që disa udhëtarë kthehen me ndonjë grup tjetër. Udhëtimi i parë i kthimit dhe udhëtimi i fundit i nisjes në shërbimet e linjës vajtje-ardhje bëhen të pangarkuara.
12. “Shërbimet e rastit” nënkuptojnë shërbimet të cilat nuk bien as nën përkufizimin e shërbimit të rregullt të udhëtarëve e as nën përkufizimin e linjës vajtje-ardhje, ku shpeshësia apo numri i shërbimeve nuk ndikon në klasifikimin si shërbim i rastit.
13. “Dokumenti i Kontrollit” nënkupton fletudhëtimin ku përfshihen të dhënat e automjetit, operatorit të transportit, vozitësve, llojit të ngarkesës, itinerarit dhe udhëtarëve.

II. TRANSPORTI I UDHËTARËVE

Neni 3

Shërbimet e rregullta të udhëtarëve

1. Shërbimet e rregullta të udhëtarëve të kryera me autobus do t’i nënshtrohen sistemit të autorizimeve të lëshuara nga autoriteti kompetent në vendin e nisjes, destinacionit dhe transitit.
2. Kërkesa për autorizim e referuar në paragrafin e parë të këtij Neni duhet të bëhet në autoritetin kompetent të vendit të themelimit të operatorit të transportit. Nëse autoriteti

kompetent i vendit të themelimit e miraton kërkesën, kërkesa i komunikohet autoritetit kompetent të vendit pritës.

Komisioni i Përbashkët i përcaktuar nën Nenin 14 vendos për formën që merr kërkesa për autorizim dhe për dokumentet e nevojshme mbështetëse si dhe për kushtet mjedisore, sigurinë dhe kushtet tjera për lëshimin e autorizimit.

3. Autorizimi i referuar në paragrafin e parë të këtij Neni lëshohet me marrëveshje të përbashkët të autoriteteve kompetente të Palëve Kontraktuese. Vendimi për dhënien e autorizimit apo për refuzimin e kërkesës duhet të merret nga autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese brenda 90 ditëve nga dita e pranimit të kërkesës për autorizim nga autoriteti kompetent i Vendi të themelimit, nëse nuk ka rrethana të paparashikuara. Në rast të rrethanave të paparashikuara, ky afat mund të ndryshohet dhe autoritetet kompetente e mbajnë të informuar njëra tjetrën. Autorizimi i referuar në paragrafin e parë të këtij Neni vlen maksimum deri në pesë vite. Përcakton kushtet operuese për kryerjen e shërbimeve të rregullta të udhëtarëve.
4. Ndryshimet në kushtet operuese dhe anulimi i shërbimeve vendosen sipas procedurave të përcaktuara në paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni. Nëse më nuk ka ndonjë kërkesë për shërbim, operatori mund ta anulojë atë duke informuar autoritetet kompetente të cilat e kanë lëshuar lejen, dhe klientët gjithashtu, brenda periudhës së përcaktuar nga Komisioni i Përbashkët, sipas Nenit 14 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 4

Shërbimet e rastit dhe shërbimet e linjës vajtje-ardhje

1. Shërbimet e rastit dhe shërbimet e linjës vajtje-ardhje të kryera nga autobusët i nënshtrohen sistemit të autorizimeve apo lejeve të lëshuara nga autoriteti kompetent në vendin e nisjes, destinacionit dhe transitit.
2. Si përjashtim në dispozitën e paragrafit 1 të këtij Neni, shërbimet e cekura më poshtë përjashtohen nga çfarëdo lloj autorizimi apo leje në territorin e Palëve Kontraktuese:
 - 2.1 turne me dyer të mbyllura përmes së cilës i njëjti autobus përdoret për bartjen e grupit të njëjtë të udhëtarëve përgjatë udhëtimit dhe i kthen ata tek vendi i nisjes, në vendin ku është themeluar operatori i transportit,

2.2 shërbimet që bartin udhëtarët nga vendi i nisjes në territorin e Vëndit të themelimit të operatorit të transportit në destinacion, duke e bërë udhëtimin e kthimit pa ngarkesë,

2.3 shërbimet që kryejnë udhëtimin e vajtjes të pa ngarkuar dhe udhëtimin e kthimit të ngarkuar, me kusht që udhëtarët:

a) përbëjnë një grup të krijuar sipas kontratës së transportit të bërë para arritjes në territorin e vëndit pritës ku ata janë marrë më herët dhe janë dërguar në territorin e vëndit të themelimit.

b) më parë janë sjellë nga i njëjti operator transporti në territorin e Palës Kontraktuese ku ata janë marrë prapë dhe janë dërguar në territorin e vëndit të themelimit.

c) janë ftuar të udhëtojnë në territorin e vëndit të themelimit të operatorit të transportit, ku shpenzimet e transportit barten nga personi i cili e ka bërë ftesën,

2.4 udhëtimi i pangarkuar me autobus i dërguar për të zëvendësuar autobusin e prishur.

3. Komisioni i Përbashkët i themeluar sipas Nenit 14 mund të vazhdojë autorizimin apo përjashtimin nga leja për kategoritë tjera të shërbimeve të rastit dhe shërbimeve vajtje-ardhje.

4. Nuk lejohet marrja dhe zbritja e udhëtarëve gjatë udhëtimit, referuar në paragrafin e dytë të këtij Neni, përveç nëse jepet autorizim i veçantë nga autoriteti kompetent i vëndit pritës.

5. Kërkesa për autorizim apo leje, referuar në paragrafin e parë të këtij Neni, duhet të bëhet në autoritetin kompetent në vëndin e themelimit të operatorit të transportit. Nëse autoriteti kompetent i vëndit të themelimit e aprovon kërkesën, kërkesa i komunikohet autoritetit kompetent të vëndit pritës.

6. Komisioni i Përbashkët i përcaktuar nën Nenin 14 vendos për formën që merr kërkesa për autorizim dhe për dokumentet e nevojshme mbështetëse. Autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese lëshojnë autorizimin, referuar në paragrafin e parë të këtij Neni, brenda një periudhe prej një muaji që nga dita e dorëzimit të kërkesës nga Autoriteti kompetent i Palës tjetër Kontraktuese. Ky afat mund të ndryshohet në rast të rrethanave të paparashikuara, për të cilën autoritetet kompetente mbajnë të informuar njëra tjetrën.

7. Gjatë kryerjes së shërbimeve të referuara në paragrafin e dytë dhe të katërt të këtij Neni, operatori i transportit duhet të mbajë në automjet një dokument kontrolli. Kushtet e

përdorimit dhe përmbajtja e dokumentit të kontrollit përcaktohen nga Komisioni i Përbashkët i referuar në Nenin 14.

Neni 5

Dispozitat e përbashkëta për shërbimet e udhëtarëve

1. Autorizimet dhe lejet e transportit të referuara në Nenin 3 dhe 4 janë personale dhe nuk mund t'i transferohen operatorëve tjerë të transportit.
2. Kryerja e shërbimeve të kabotazhit është e ndaluar. Udhëtimet lokale të organizuara vetëm për grupe të udhëtarëve të sjellë në atë lokacion nga i njëjti operator i transportit nuk konsiderohen shërbime kabotazhi, me kusht që ato futen në dokumentin e kontrollit.

III. TRANSPORTI I MALLRAVE

Neni 6

Sistemi i lejeve

1. Operatorët e transportit të themeluar në territorin e Palës Kontraktuese, sipas sistemit të lejeve, në territorin e Palës tjetër Kontraktuese kryejnë:
 - 1) transportin në mes territoreve të dy Palëve Kontraktuese,
 - 2) transportin në mes një pike në territorin e Palës tjetër Kontraktuese dhe një pike në territorin e Shtetit të tretë.
2. Kabotazhi lejohet vetëm me autorizim të veçantë të lëshuar nga autoriteti kompetent i vendit pritës.

Neni 7

Transporti i përjashtuar nga marrja e lejes

1. Si përjashtim nga dispozitat e Nenit 6, kategoritë në vijim janë të përjashtuara nga marrja e lejes:
 - 1) Transporti me automjete Pesha Totale e Ngarkesës së Lejueshme e të cilave, duke përfshirë rimorkiot, nuk tejkalon peshën prej 6 tonësh, apo kur ngarkesa e lejuar që sjell fitim nuk tejkalon peshën prej 3.5 tonësh.

2) Transporti i rastit nga ose deri në aeroport në rastet kur shërbimet e rregullta ajrore ndërrojnë drejtimin.

3) Transporti i automjeteve të cilat janë dëmtuar apo janë prishur dhe transporti i automjeteve që duhet të riparohen.

4) Udhëtimet pangarkuara me automjete të mallrave të dërguara për të zëvendësuar automjetin e mallrave që është prishur në një vend tjetër, dhe gjithashtu udhëtimi i shkurtër i kthimit, pas riparimit, i automjetit që është prishur.

5) Transporti i bagëtisë me automjete të ndërtuara për qëllime të veçanta apo automjete të konvertuara përkohësisht për transportin e bagëtisë.

6) Transporti i pjesëve rezervë dhe furnizimet për aeroplanë dhe anije transoqeanike.

7) Transporti i pajisjeve dhe furnizimeve mjekësore të nevojshme për urgjenca, në veçanti për reagim ndaj fatkeqësive natyrore dhe nevojave humanitare.

8) Transporti i punimeve dhe objekteve të artit për panairë dhe ekspozita apo për qëllime jo-komerciale.

9) Transporti për qëllime jo-komerciale të pasurisë, pajisjeve shtesë apo kafshëve në apo nga performancat teatrale, muzikore, film, sport apo cirk, panairë apo festa, dhe pajisjet të cilat kërkohen urgjent për incizime në radio, film apo produksion televiziv.

10) Largimi i bërë me pajisje dhe staf adekuat.

11) Transporti për funerale.

12) Pjesa e parë dhe e fundit – ndërkombëtare dhe kombëtare – me transport rrugor të kombinuar, me kusht që të shfrytëzohet stacioni më i afërt i pikës së ngarkimit dhe shkarkimit.

13) Transporti i postës.

2. Komisioni i Përbashkët i përcaktuar nën Nenin 14, me marrëveshje reciproke mund të shtojë apo të largojë listën e kategorive të transportit të përcaktuar në paragrafin e parë të këtij Neni të cilët përjashtohen nga marrja e lejes.

3. Komisioni i Përbashkët i përcaktuar në Nenin 14, mund të përjashtojë nga sistemi i lejeve të gjitha kategoritë e transportit për një periudhë të caktuar kohore.

Neni 8

Dispozitat e Përbashkëta për transportin e mallrave

1. Autoritetet kompetente të të dy Palëve Kontraktuese pajtohen për numrin e lejeve dhe çdo vit shkëmbejnë forma të lejeve të zbrazëta të cilat vlejnë 13 muaj që nga fillimi i secilit vit kalendarik.

2. Leja e referuar në paragrafin e parë të këtij Neni nuk mund të transferohet.

3. Leja e referuar në paragrafin e parë të këtij Neni mund të përdoret vetëm për një automjet. Në rast të kombinimit të automjeteve, automjeti motorik është faktori vendimtar për lëshimin e lejes apo për përjashtim nga ajo.

4. Komisioni i Përbashkët i referuar në Nenin 14 përcakton kuotën, kategorinë, kushtet për lëshimin dhe përdorimin e formave të zbrazëta të lejes si dhe kushtet sipas së cilave kategoritë e veçanta të transportit mund të përjashtohen nga sistemi i lejeve.

5. Udhëtimi me shërbime të kabotazhit është i ndaluar, përveç kur është i autorizuar nga autoriteti kompetent i vendit pritës.

IV. DISPOZITAT E PËRBASHKËTA

Neni 9

Vënia e taksave

1. Transporti me anë të automjeteve të regjistruara në territorin e njërës Palë Kontraktuese dhe që operon përkohësisht në territorin e tjetrës Palë Kontraktuese është, sipas dispozitave të kësaj Marrëveshjeje dhe sipas parimit të reciprocitetit, i përjashtuar nga pagesa e të gjitha taksave që kanë të bëjnë me pronësinë, regjistrimin dhe drejtimin e automjetit.

2. Karburanti i mbajtur në rezervuarin e zakonshëm, të ndërtuar nga prodhuesi në rezervuarin e fiksuar të automjetit i dedikuar për drejtim të automjetit, si dhe lubrifikantët dhe pjesët rezervë, janë të përjashtuara nga të gjitha taksat e importit në territorin e vendit pritës me kusht që operatori i transportit t'i përmbahet rregullave relevante të doganës.

3. Transporti i mbuluar nga dispozitat e kësaj Marrëveshjeje në vendin pritës i nënshtrohet pagesës për shfrytëzimin e rrugës, tarifave dhe taksave tjera të vëna për shfrytëzimin e rrjetit të rrugës, urave, tuneleve etj. në vendin pritës. Tarifat dhe detyrimet vendosen për operatorët e transportit lokal dhe atij të jashtëm pa diskriminim.

4. Komisioni i Përbashkët, i referuar në Nenin 14, mund të marrë parasysh dhe t'u propozojë autoriteteve kompetente përjashtimin e pjesshëm apo të tërësishëm, në bazë reciproke, nga pagesa e taksave nga operatori i transportit në lidhje me kryerjen e shërbimeve të transportit.

Neni 10

Pesha dhe dimensionet e automjetit

1. Pesha maksimale e lejuar, pesha e boshtit dhe dimensionet e automjetit nuk guxojnë të tejkalojnë ato që janë të shënuara në dokumentin e regjistrimit apo kufirin më të lartë që është në fuqi në vendin pritës.

2. Përdorimi i automjeteve në vendin pritës, pesha dhe dimensionet e të cilave tejkalojnë kufirin më të lartë të lejuar, lejohet vetëm me autorizim të veçantë të lëshuar nga autoriteti kompetent i vendit pritës dhe nëse paraprakisht aplikon për të.

Neni 11

Pajisjet dhe karakteristikat e tjera të automjetit

1. Automjetet që bartin mallra të rrezikshme apo mallra që prishen duhet të pajisen dhe të furnizohen në përputhje me rregullat ndërkombëtare (kërkesat e ADR apo Marrëveshjet e ATP).

2. Pajisjet që shfrytëzohen për monitorimin e ekuipazhit të vozitësve dhe pushimit në automjet duhet të jenë në përputhje me rregullat ndërkombëtare (dispozitat e Marrëveshjes AETR).

3. Palët Kontraktuese ndërmarrin përkrahjen, sipas kësaj Marrëveshjeje, e përdorimit të automjetit që nënkupton sigurinë dhe standardet e emetimit. Në pajtim me rregullat e BE-së në këtë fushë, të njëjtat aplikohen me detyrimet e ndërmarrja ndërkombëtare.

4. Në përputhje me paragrafin e tretë të këtij Neni, Komisioni i Përbashkët i përcaktuar në Nenin 14, kur vendoset për kuota dhe liberalizimin e mundshëm në të ardhmen, mund

të japë trajtim më të favorshëm të automjeteve të cilat plotësojnë standardet më moderne të sigurisë dhe mjedisit.

Neni 12 **Kontrolli**

Lejet dhe të gjitha dokumentet tjera të parapara me marrëveshje bilaterale apo multilaterale apo me ligjin kombëtar, duhet të mbahen në automjet dhe të paraqiten me kërkesën e autoriteteve kompetente të vendit pritës.

Neni 13 **Detyrimet e operatorëve të transportit dhe shkeljet**

1. Operatorët e transportit të Palës Kontraktuese dhe ekuipazhi i automjeteve të tyre, kur janë në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, duhet t'u përmbahen ligjeve dhe rregulloreve në fuqi të vendit pritës.
2. Në rast të kryerjes së ndonjë shkeljeje të dispozitave të kësaj Marrëveshjeje nga operatori i transportit në vendin pritës, autoriteti kompetent i vendit pritës e njofton autoritetin kompetent të vendit të themelimit me qëllim që ky i fundit të ndërmarrë masat e nevojshme kundër operatorit të transportit, ashtu siç parashihet me legjislacionin e tij kombëtar.
3. Palët Kontraktuese do të mbajnë të informuar njëra tjetrën për vënien e sanksioneve.
4. Dispozitat e paragrafit të parë dhe të dytë të këtij Neni nuk do të përjashtojnë masat e ndërmarra nga gjyqësori ose autoritetet e tjera kompetente të vendit pritës.

Neni 14 **Bashkëpunimi dhe Komisioni i Përbashkët**

1. Autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese janë të obliguara të marrin të gjithë hapat e nevojshëm për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje dhe do të mbajnë të informuar njëra tjetrën për ndonjë informacion të dobishëm dhe për ndonjë ndryshim në ligjin kombëtar që mund të ndikojë në zbatim.
2. Autoritetet kompetente do t'i ofrojnë njëra tjetrës asistencë reciproke për qëllimin e implementimit të kësaj Marrëveshjeje.

3. Palët Kontraktuese do të themelojnë një Komision të Përbashkët me qëllim të implementimit të kësaj Marrëveshjeje dhe që të merret me çështjet që kanë të bëjnë me këtë Marrëveshje.

V. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 15

Autoritetet Kompetente

Autoritetet kompetente për implementimin e kësaj Marrëveshjeje janë:

- në Republikën e Kosovës: Ministria, e cila është përgjegjëse për transportin rrugor të udhëtarëve dhe të mallrave,
- në Republikën e Sllovenisë: Ministria, e cila është përgjegjëse për transportin rrugor të udhëtarëve dhe të mallrave,

Neni 16

Hyrja në fuqi dhe afati i vlefshmërisë së Marrëveshjes

1. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi atëherë kur Palët Kontraktuese njoftojnë njëra tjetrën përmes kanaleve diplomatike se janë kompletuar procedurat për hyrjen e saj në fuqi në përputhje me legjislacionin kombëtar.

2. Kjo marrëveshje do të mbetet në fuqi, përveç nëse përfundohet me njoftim me shkrim përmes kanaleve diplomatike nga njëra Palë Kontraktuese. Në këtë rast, përfundimi i Marrëveshjes do të hyjë në fuqi gjashtë muaj pasi që Pala Kontraktuese ka pranuar njoftimin e përmendur më lart.

Në dëshmi të kësaj, të nënshkruarit më poshtë, duke qenë të autorizuar për këtë, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje.

Nënshkruar në Lubjanë më 26 Qershor 2013 në dy kopje origjinale në gjuhën angleze.

Për Qeverinë e Republikës
së Kosovës

Për Qeverinë e Republikës
së Sllovenisë
